

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RUBIX MEDIA" Sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 06.09.2022(dymije e njezet e dy), nenshkruhet ky Akt Themelimi i Shoqerise " **RUBIX MEDIA**" Shpk nga: "**Rubix Hollding Group**" **sh.p.k.** shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar si person juridik prane qendres kombetare te regjistrimit Tirane me **NUIS M21508003D** me adrese. **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane.** E cila, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " **RUBIX MEDIA**" Shpk.

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakëve është e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te Shoqerise, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjetër.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise është " **RUBIX MEDIA** " Sh.p.k.

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit te Themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Veprimtaria e Shoqerise " **RUBIX MEDIA**" Shpk do të ketë për objekt:

Objekti i shoqerise është si më poshtë: Shoqëria do të ketë Statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

Shoqëria ka për objekt aktivitet si vijon:

Në fushën e Menaxhimit dhe Marketingut: Konsulencë dhe Trajnime Profesionale dhe për biznesin për ndërkombëtarizimin e kompanive.

Konsulencë dhe Trainime, Marketing për Zhvillimin e Biznesit dhe përthithjen e klientëve. Konsulencë dhe Trajnim në Menaxhimin e kompanive për zhvillimin dhe zgjerimin e tyre; Konsulencë dhe Trajnim Profesional për biznesin në bashkëpunim me zyra ligjore ndërkombëtare.

Konsulencë dhe Trajnim Profesional për biznesi bashkëpunim me zyrat fiskale ndërkombëtare. fushën e Menaxhimit dhe Reklamimit.

Konsulencë dhe Trajnim, Marketing për imazh profesional dhe/ose për biznesin; Konsulencë dhe Trajnim per reklamime për zhvillimin e imazhit të biznesit dhe/ose profesional.

Zhvillim, Trajnim dhe krijim, prodhim dhe realizimin e cdo forme të reklamimit, dixhitale, web, në letër, etj.

Në fushën e Produksionit Televiziv, Muzikë, Kinema, Reklama, Botime, Evente: Konsulencë dhe Trajnim për zhvillimin e Produkt Placement të kompanisë dhe/ose profesionale.

Krijimi dhe shitja e skenareve apo teksteve në lidhje me fushën e spektakleve.

Trajnime në fushën e televizionit, kinematografisë dhe web; Prodhime dhe shpërndarje e filmave me metrazh të shkurtër, filmave me metrazh të mesëm dhe filmave me metrazh të gjatë për Kinematë.

Prodhimi dhe shpërndarja e filmave me metrazh të shkurtër, me metrazh të mesëm dhe atyre me metrazh të gjatë dhe Tv dixhitale, satelitore dhe/ose për reklamim të çfarëdo lloj forme. Prodhimi dhe shpërndarja e muzikës dixhitale, live, në dyqane dhe në të gjitha format e shitjeve.

Prodhimi dhe shpërndarja e librave, revistave, fletushkave, etj., në format letre dhe/ose dixhitale; Krijimi dhe realizimi i eventeve për individë dhe ente publike.

Në fushën e Turizmit: Aktivitete të Promovimit dhe Trajnimit në fushën e Turizmit në çfarëdo lloj forme dhe mjete;

Aktivitete të realizimit të objekteve turistike në çfarëdo lloj formë dhe mjete; Aktivitete të ndërmjetësimit dhe të trajnimit në fushën e turizmit; Aktivitete të bashkëpunimit, konsulencës.

Trajnimit me struktura turistike publike dhe private; Aktivitete bashkëpunimi, konsulence dhe Trajnimi me organe publike dhe private. Në fushën e Biznesit, Aktivitete krijimi, Trajnime, dhe zhvillimi të mundësive të reja të biznesit midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera me vëmendje të veçantë në fushën territoriale dhe eksportimin e të mirave materiale, shërbimeve, lëndëve të para, etj.

Aktivitete krijimi, Trajnime dhe krijime të aktiviteteve që kontribuojnë në zhvillimin e investimeve, si dhe punësimin në Shqipëri nga investitorë kombëtarë dhe të huaj. Gjithashtu mund të ushtrojë çfarëdo lloj aktiviteti plotësuese, aksesori, të ngjashëm apo të lidhur si më sipër parashikuar.

Shoqëria edhe me qëllimin për të promovuar, imaxhin e saj në të gjithë territorin kombëtar, dhe jashtë saj, mund të ndërmarë të gjitha iniciativat të cilat janë të përshtatshme për qëllimin, të cilat janë: regjistrimin e markave apo të patentave; kurse formimi dhe axhornimi profesional; krijimit, botimit, përhapjes, shpërndarjes dhe shitjes së librave, revistave apo të ngjashëm në sektoret e latëpërmëndura; ekspozitave manifestimet në përgjithësi, edhe duke bashkëpunuar për këtë gjë me organizatat e kategorisë të pranishme në të gjithë territorin.

Shoqëria, me vendim të Administratorit, dhe pas miratimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme, mund të lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

Neni 5

Selia

Selia e Shoqërisë " **RUBIX MEDIA**" Shpk është në adresën: **Torre Drin Rrugën, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane. Shqipëri.**

Neni 6

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

Neni 7

Kapitali i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise " **RUBIX MEDIA**" Shpk eshte 10 000 (dhjetemije) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktimeve ligjore. Kapitali do te ndahet ne 1 (nje) kuot. Ky kapital eshte formuar nga themeluesja e shoqerise si me poshte: "**Rubix Holding Group**" **sh.p.k.** me 10 000 (dhjetemije) leke duke zoteruar 100 % te kuotave 1 (nje kuot).

Neni 8

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem me nje mandat 5(pese) vjecar.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. **Edmond Petraj**

Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

Neni 9

Te ardhurat

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se vitit ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 10

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen Shqipe dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKET THEMELUES:

"Rubix Holding Group"

Administratori Edmond Petraj



